



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



PLANI STRATEGJIK I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT 2023-2026

PËRMBAJTJA

Fjala e auditores së përgjithshme.....	3
1. Hyrja	4
2. Partnerët strategjik	5
3. Vizioni, misioni dhe vlerat e zka-se	7
4. Qëllimet dhe objektivat strategjike	8
Qëllimi 1: Pavarësia, standardet, cilësia	9
Qëllimi 2: Kapacitetet dhe burimet	10
Qëllimi 3: Imazhi dhe ndikimi	12
5. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Planit strategjik	13
SHTOJCA I: Metodologjia	15



Thelbi i misionit të Zyrës Kombëtare të Auditimit është që të sigurojë Kuvendin e Kosovës, autoritetet tjera dhe qytetarët, me informacion objektiv dhe të pavarur mbi gjendjen e institucioneve publike që përbëjnë strukturën e shtetit, lidhur me menaxhimin e burimeve publike të besuara. Ashtu siç e përcaktojnë edhe Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit duhet të shërbejë shembull në sektorin publik.

Për të jetësuar deklaratat më lartë, si dhe me qëllim që të sjellim ndryshimin pozitiv në jetën e qytetarëve, kam aprovuar Planin Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit për periudhën 2023-2026, i cili trason rrugëtimin e institucionit për vitet e ardhshme.

Çdo fushë, qëllim, objektivë dhe aktivitet është përzgjedhur me kujdes të veçantë dhe gjithmonë duke pas parasysh shkallën e zbatimit dhe ngecjet e identifikuara në planet e kaluara.

Zyra Kombëtare e Auditimit është ndërtuar mbi baza të forta ligjore dhe institucionale, të zhvilluara në bashkëpunim me Institucionet Supreme të Auditimit evropiane. Është anëtare me të drejta të plota në INTOSAI dhe EUROSAI. Ka staf kompetent dhe të përkushtuar, si dhe mekanizma dhe procedura të qarta dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Sidoqoftë, avancimi i pavarësisë institucionale në përputhje me parimet kyçe të INTOSAI-t, është një prej qëllimeve kryesore. Kjo duhet të arrihet me qëllim të optimizimit më të madh të procesit të auditimit financiar, i cili për momentin qëndron në fokus të ZKA-së, dhe duke orientuar burimet e nevojshme për të forcuar auditimet e performancës dhe të teknologjisë së informacionit dhe ndërmarrjeve publike, që mund t'i ofrojnë Kuvendit dhe qytetarëve analiza dhe përfundime më të rëndësishme në çështjet e sektorit publik.

Po ashtu, synimi që të jemi institucion shembull në sektorin publik, kërkon nga ne zbatimin e rreptë të parimeve dhe vlerave kyçe lidhur me integritetin, llogaridhënien dhe transparencën në proceset tona të brendshme organizative. Andaj, synimi ynë është mishërimi me këto vlera, ku e gjithë Zyra vendoset në një institucion vetë-mësimi, ku puna e palodhshme, integriteti, përgjegjësia dhe inovacioni janë të mirëpritura dhe promovohen.

Komunikimi me Kuvendin, institucionet e tjera dhe shoqërinë civile duhet të rivendoset në një rol më proaktiv dhe dinamik, me dialog të sinqertë dhe të vazhdueshëm, në mënyrë që të ndihmojë autoritetet të marrin vendime të informuara.

Për ta përmbledhur, qëllim kryesor i planit strategjik është që ZKA-ja të rritet në një institucion që orienton të gjitha aktivitetet e brendshme dhe të jashtme drejt ndikimit të dëshiruar në funksionimin e shtetit, ku udhëheqësit, menaxherët dhe personeli tjetër i institucioneve publike i kuptojnë rolet e tyre, procesin e përgjithshëm shtetëror dhe veprojnë për të mirën e gjithmbarshme.

Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, Janar 2023

1. HYRJA

ZHVILLIMI I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT



Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në vend dhe Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj.

Vizioni ynë është që të jemi institucion i besueshëm i auditimit, i cili e përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve dhe përmes auditimeve cilësore e fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorim efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (tani, Zyra Kombëtare e Auditimit) është themeluar nga Administrata e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në nëntor 2003. Auditori i parë i Përgjithshëm është emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 15 qershor 2008, Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka të drejtë të kontrollojë të gjitha

aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e asetëve, privatizimeve dhe koncesioneve. Për herë të parë në vitin 2016, Auditori i Përgjithshëm vendor është emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ushtron mandatin e tij në përputhje me legjislacionin vendor dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA-të).

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien dhe ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogaridhënie udhëheqësëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit është anëtare me të drejta të plotë e dy organizatave të auditimit: INTOSAI dhe EUROSAI.

2. PARTNERËT STRATEGJIK TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT


Bashkëpunimi me palët e interesit dhe partnerët tjerë është objektivë strategjike e ZKA-së dhe përmes angazhimit të vazhdueshme, ne kemi krijuar marrëdhënie të mira bashkëpunimi.

Partnerët kryesor strategjik, janë:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Komisionet Parlamentare (në veçanti: Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT);
- Qytetarët e Kosovës;
- Organizatat e Shoqërisë Civile;
- Donatorët;
- Institucionet Akademike;
- Partnerët Ndërkombëtar (INTOSAI, EUROSAI, Gjykata Evropiane e Auditorëve, dhe Institucionet tjera Supreme të Auditimit).

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Me qëllim të zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, si dhe rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të institucionit, Zyra Kombëtare e Auditimit është e fokusuar në ruajtjen dhe avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit me organizata të ndryshme ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon dhe më gjerë.



Në nivel ndërkombëtar, Zyra Kombëtare e Auditimit, është anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Në nivel regjional, ZKA ka bashkëpunim të mirë me institucionet homologe të regjionit përmes Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për anëtarësim në BE dhe Grupit të Përbashkët Punues për Aktivitetet në Auditim i themeluar nga Komiteti i Kontaktit.

Me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe përvojës në auditim, ZKA ka rritur bashkëpunimet bilaterale me ISA-të tjera dhe ka të nënshkruara marrëveshje të bashkëpunimit bilateral me:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë;
- Gjykata Turke e Llogarive;
- Zyra e Auditimit të Uellsit;
- Institucioni Suprem i Auditimit të Çekisë; dhe
- Enti Shtetëror i Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdimësi synon të rrisë dhe zhvillojë bashkëpunimin e saj ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativat dhe aktivitetet e këtyre organizatave. Aktualisht ZKA jep kontributin e saj dhe përfiton nga pjesëmarrja në grupe punuese dhe taskforca të INTOSAI-it dhe EUROSAI-it, siç janë:

- Task-forca e EUROSAI-t për auditimin e komunave;
- Grupi punues për auditimet e TI-së;
- Projekt Grupi i EUROSAI-t për ndërtimin e kapaciteteve për angazhimin me OSHC-të” ; dhe
- Projekt Grupi i EUROSAI-t për Etikë.

ZKA ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organet dhe komitetet e INTOSAI, siç është Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI (IDI) si dhe Komitetin për Standardet Profesionale, dhe Komitetin për Ndërtimin e Kapaciteteve.



Përmes këtij plani strategjik, ZKA do të vendos projeksione të qarta të angazhimit të saj sa i përketë rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar.

3. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



Vizioni

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



Misioni

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.



Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.



Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikatat e mira të vendeve tjera.



Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përftuar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.



Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

4. QËLLIMET STRATEGJIKE

Ne do të kryejmë auditime në përputhje me mandatin kushtetues e ligjor, si dhe kornizën e INTOSAI-t për deklaratat profesionale.

Kapacitetet institucionale mundësojnë menaxhim dhe auditime efektive.



Ne do të rrisim ndikimin tonë përmes bashkëpunimit cilësor me palët e interesit

1. PAVARËSIA, STANDARDET, CILËSIA

Ne do të kryejmë auditime në përputhje me mandatin kushtetues e ligjor, si dhe kornizën e INTOSAI-t për deklaratat profesionale.

	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme -treguesit e performancës
1	Të forcohet dhe të përcaktohet qartë pavarësia organizative, funksionale, financiare dhe mandati i ZKA-së në harmoni të plotë me deklaratën e Lima-s dhe Meksiko-s.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndryshimi i ligjit dhe harmonizimi i ligjeve të veçanta të disa subjekteve audituese me mandatin kushtetues dhe ligjor të ZKA-së. ➤ Rregullimi i unifikuar i marrëdhënies së punës dhe rregullimi i imunitetit funksional që garanton nga ndjekja penale dhe civile që ka ndikim direkt në pavarësinë e auditorëve. ➤ Procedura e përgatitjes dhe aprovimit të buxhetit në përputhje me kërkesat e INTOSAI, që nënkupton me aprovim direkt nga Kuvendi i Kosovës.
2	Përcaktimi i qasjes në përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndryshimet e nevojshme ligjore që auditimet të kryhen bazuar në rrezik. ➤ Zhvillimi i qasjes në përzgjedhjen e entiteteve publike dhe temave audituese duke u bazuar në faktorë potencial, si; rreziku, kompleksiteti, ndjeshmëria, interesi publik e tjera. ➤ Hartimi dhe publikimi i planit të auditimi bazuar në rrezik.
3	Caktimi i fushave strategjike për auditime financiare, pajtueshmërisë dhe të performancës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Auditimi i temave relevante për Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. ➤ Bashkëpunimi dhe përfshirja e palëve të interesit gjatë procesit të auditimit, bazuar në praktikatat dhe udhëzuesin e INTOSAI-it.
4	Avancimi i metodologjisë së auditimit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përditësimi dhe adaptimi i ndryshimeve të standardeve të INTOSAI-t, si dhe përkthimi i tyre. ➤ Zhvillimi dhe përditësimi i Doracakëve të auditimit konform ndryshimeve të fundit në SNISA dhe legjislacionit në fuqi. ➤ Zhvillimi i udhëzuesve që lidhen me auditimet e performancës dhe pajtueshmërisë, në fusha specifike.
5	Avancimi i kontrollit dhe sigurimit të cilësisë për auditimet financiare, pajtueshmërisë dhe performancës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Stafi auditues i trajnuar konform udhëzuesve të zhvilluar/përditësuar. ➤ Udhëzues të rishikuar për kontrollin/sigurimin e cilësisë për llojet e auditimeve që kryen ZKA-ja. ➤ Plotësimi me staf të mjaftueshëm të DSC. ➤ Zhvillimi i mekanizmave efektiv për përcjellje të rekomandimeve tek auditimet e performancës.
6	Avancimi i Sistemit për Menaxhim të Auditimit -SITA, si dhe avancimi i kompetencave të personelit në përdorimin e tij.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ SITA i plotëson vazhdimisht kërkesat që dalin nga ndryshimet dhe përditësimet e metodologjisë. Sistemi avancohet me funksione shtesë, si integrimi me arkivën digjitale. ➤ Përdoruesit e SITA-s e zotërojnë mirë sistemin dhe japin kontributin për avancimin e saj.
7	Rritja e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe performancës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rritja e vazhdueshme numrit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe të performancës në raport me vitin paraprak, që rezulton me ndikimin e auditimeve në qeverisjen e mirë dhe mirëqenien e qytetarëve

2. KAPACITETET DHE BURIMET

Kapacitetet institucionale mundësojnë menaxhim dhe auditim efektive.

	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme- treguesit e performancës
1	Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare në rritjen e kapaciteteve audituese.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rritja e bashkëpunimit me Kuvendin në plotësimin e nevojave financiare që ndikon në rritjen e kapaciteteve audituese (me staf).
2	Ruajtja dhe tërheqja e stafit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Plani i hartuar për mbajtjen dhe ruajtjen e stafit. ➤ Mekanizmat stimulues të krijuara që ndikojnë në ruajtjen e potencialit profesional brenda zyrës (promovimin, mirënjohje, trajnime profesionale, mjedis bashkëpunues dhe atraktiv) etj.
3	Avancimi dhe zhvillim profesional, bazuar në vlerësimin e rezultateve të punës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përditësimi i akteve të brendshme në përputhje me standardet e auditimit (SNISA 150) për vlerësimin e rezultateve të punës. ➤ Mbështetja e punonjësve të talentuar me programe të zhvillimit të karrierës (certifikime vendore dhe ndërkombëtare për gjitha llojet e auditimeve). ➤ Zhvillimi i planeve të trajnimit për punonjësit/ auditorët e performancës, prokurimit dhe TI-së sipas nevojës. ➤ Identifikimi i burimeve të brendshme/jashtme të trajnerëve për auditime të pajtueshmërisë dhe të performancës.
4	Fuqizimin e shërbimeve financiare dhe njerëzore.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi i doracakëve dhe procedurave për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrative. ➤ Hartimin e një udhëzues për zbatimin praktik të akteve të brendshme. ➤ Zhvillimi i pakos hyrëse për njohjen e veprimtarisë së ZKA-së dhe trajnime që mbahen nga stafi i brendshëm. ➤ Avancimi i procedurave për çështje financiare dhe administrative (planifikimin e buxhetit, procedurat për forcimin e kontrollit brendshëm në kuadër të njësive organizative).
5	Shtohet kujdesi për mirëqenien e stafit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi i programit që ndikon në mirëqenien e stafit (përkrahje financiare me bashkëpunues për qëllime profilaktike).
6	Të sigurohet hapësirë të përshtatshme për punë dhe mbështetje teknike për transport.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Objekti i përshtatshëm dhe hapësira e mjaftueshme e punës në objekte në pronësi publike. ➤ Blerja e automjeteve dhe zhvillimi i mundësive alternative në përmbushjen e nevojave për transport (taxi, shfrytëzimi i mjeteve private, mirëmbajtje pasurive ekzistuese).

7	Avancimi i procedurave për menaxhimin e pajisjeve dhe rreziqeve në TI.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Në bashkëpunim me Grupin këshillues të TI-së të hartohen dhe plotësohen procedurat tjera shtesë të nevojshme për menaxhim me efikas të punës së TI-së. ➤ Grupi Këshillues për TI, në vazhdimësi i analizon projektet dhe nevojat e TI-së që ofron cilësi dhe siguri në funksionimin e sektorit të TI-së në ZKA.
8	Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Funkcionalizimi i sistemit elektronik (digjitalizimi) për menaxhimin e burimeve njerëzore në ZKA.
9	Mirëmbajtja e vazhdueshme e etikes profesionale.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kodi i etikes i përshtatur në përputhje me standardet e INTOSAI dhe legjislacioni në fuqi. ➤ Stafi i trajnuar dhe i ndërgjegjësuar mjaftueshëm me parimet etike. ➤ Monitorimin i vazhdueshëm i zbatimit të vlerave thelbësore etike.
10	Përcjellja e planeve vjetore dhe operative në arritjen e rezultateve audituese në kohe dhe cilësi.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mekanizmi i krijuar për përcjelljen dhe monitorimin e progresit të planit strategjik, vjetor të punës audituese dhe planeve operative.

3. IMAZHI DHE NDIKIMI


Ne do të rrisim ndikimin tonë përmes bashkëpunimit cilësor me palët e interesit.

	Objektivat strategjike	Rezultatet e pritshme -treguesit e performancës
1	Rritja e ndikimit të ZKA-së përmes komunikimit efektiv me palët e jashtme.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Strategjia e komunikimit 2020-2022 e rishikuar dhe përshtatur për periudhën e re strategjike dhe në fuqi. ➤ Bashkëpunimi i rritur me Kuvendin dhe komisionet parlamentare. ➤ Bashkëpunimi i rritur me palët e interesit si: OJQ, donatorët akademikë. ➤ Numri i rritur i raporteve të auditimit të shqyrtuar nga komisionet përkatëse. ➤ Kapacitet i rritur i stafit.
2	Vlerësim i pavarur dhe profesional të punës së ZKA-së-(Peer reeview).	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rritja e bashkëpunimit me Kuvendin e Kosovës për iniciimin dhe kryerjen e vlerësimit të pavarur dhe profesional të punës së ZKA-së (Peer reeview) nga një ISA apo organizatë profesionale, konform (SNISA 20 dhe ligjit për AP dhe ZKA) .
3	Të rritet bashkëpunimin me OB për zbatimin e rekomandimeve dhe të zhvilloj një sistem për evidentimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimin e takimeve dhe kampanjave vetëdijësuse me OB me qëllim të zbatimit të rekomandimeve. ➤ Në bashkëpunimi me kuvendin harton një plan të përshtatshëm që nxit OB në rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve. ➤ Funkcionalizimin e plotë të databazës për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve. ➤ Listimi i OB që kanë nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve i publikuar në web faqe.
4	Të rritet bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfereveqë gjatë hartimit të ligjit të buxhetit të merren në konsideratë raporte e ZKA-së dhe nivel i zbatimit të rekomandimeve nga OB-re.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me mekanizmat përkatëse që gjatë dëgjimeve buxhetore të OB të merren për bazë raportet e auditimit në hartimin e ligjit për buxhet. ➤ Sinkronizmi në mes kohës se publikimit të RVA-se dhe aprovimit të raportit të qeveri së.
5	Avancimi i mekanizmave për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm të ZKA-së.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi i procedurës për komunikim të brendshëm. ➤ Zhvillimi i platformës së komunikimit elektronik të stafit jo vetëm për çështje audituese por edhe për shërbime korporative, përmes modulit të veçantë në SITA ose Intranet. ➤ Udhëzuesi për komunikim dhe qasjen aktive në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare i hartuar dhe në fuqi.

5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT STRATEGJIK

Zbatimi i planit strategjik të ZKA-së për këte periudhë kohore do të varet nga vullneti dhe përkushtimi i vetë ZKA-së për të zbatuar aktivitetet e parapara në strategji përmes planit operacional dhe planit vjetor të saj. Megjithatë monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i progresit në zbatimin e strategjisë, si dhe evidentimi me kohë i problemeve dhe sfidave kanë rëndësi kryesore në suksesin saj.

Ekzistojnë dy faza/metoda përmes të cilave monitorohet, raportohet dhe vlerësohet sukcesi i strategjisë dhe zbatimi i saj:



- Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e planit strategjik; dhe
- Vlerësimi i Strategjisë dhe efektet e saj

a. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e planit strategjik

Për **zbatimin** e Planit strategjik do të hartohen **plani vjetor** i auditimit në përputhje me kërkesat ligjore (për sezonin e auditimit 1 shtator – 31 gusht) dhe **plani operativ** (operacional) njëvjeçar (sipas vitit kalendarik).

Plani vjetor i auditimit përfshinë informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditori i Përgjithshëm për sezonin auditues për çdo vit. Ndërsa, plani operativ përfshinë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin dhe burimet e financimit, rezultatet, rreziqet për zbatimin e planit strategjik. Ky plan përveç projekteve dhe aktiviteteve të ndërlidhura me Planin strategjik, duhet të përfshijë edhe çështje operative të cilat duhet të planifikohen.

Gjatë zbatimit të Planit strategjik është i domosdoshëm **monitorimi** i tij. Ky është një proces që kërkon përcjelljen e vazhdueshme të projekteve dhe aktiviteteve që kanë për qëllim përmbushjen e objektivave strategjike dhe arritjen e rezultateve të dëshirueshme.


Kjo i ndihmon ZKA-së që të ndërmarrë veprimet e nevojshme profilaktike dhe përmirësuese atëherë kur zhvillimet/aktivitetet nuk janë duke ndodhur në përputhje me planin apo edhe për shkak të ndryshimeve në ambientin e brendshëm dhe jashtëm. Monitorimi kryhet në përputhje me strukturën organizative dhe menaxheriale të ZKA-se të aprovuar nga Auditorja e Përgjithshme.

Kjo strukturat koordinuese për monitorim dhe Raportim të strategjisë do të themelohet me vendim të Auditorës së Përgjithshme dhe do të përbëhet nga udhëheqësit divizioneve të cilat kanë detyra në planin Operacional dhe Vjetor. Vendimi për themelimin e grupit koordinues do të përcaktojë qartë përbërjen e grupit, rolet dhe përgjegjësitë në monitorimin e arritjeve të rezultateve dhe raportimin e tyre, të cilat do mbikëqyren dhe koordinohen nga departamenti për planifikim strategjik.

Procesi i raportimit - Raportimi për zbatimin e Strategjisë përmes planit të zbatimit do të bëhet në baza *gjashtë mujore dhe vjetore*.

Raporti vjetor ka për qëllim të raportojë dhe vlerësojë progresin e zbatimit të strategjisë kundrejt çdo objektivi, ndërsa vlerësimi i arritjeve bëhet përmes indikatorëve, caqeve (targets) vjetore. Përveç progresit të arritur në objektiva dhe tregues gjatë vitit të raportimit, raporti do të përmbajë informata nëse janë zbatuar me kohë aktivitetet e planifikuara secili veç e veç, përdorimi i burimeve financiare, pengesat dhe sfidat për zbatim dhe propozimin e masave për tejkalimin e tyre me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete.

b. Vlerësimi i planit Strategjik



ZKA do të bëjë edhe **vlerësimin** e zbatimit të Planit strategjik për të matur shkallën e realizimit të performancës të objektivave strategjike në raport me treguesit e performancës, pra pritshmëritë. Vlerësimi i Planit do të bëhet nga një ekip profesionale e caktuar nga Auditorja e Përgjithshme dhe e mbikëqyrur nga departamenti për planifikim strategjik në kuadër të strukturës organizative të ZKA-së.

Raporti i përgjithshëm bëhet në fund të zbatimit të planit strategjik dhe do të shërbejë si bazë për një rishikim të lehtë të strategjisë, sidomos në nivel të objektivave specifike, treguesve, caqeve, si dhe baza për hartimin e planit të ri strategjik.

SHTOJCA I:

METODOLOGJIA

Ekipi për planifikim strategjik i themeluar me vendim të AP-së, duke u bazuar në Doracakun për Planifikim Strategjik për Institucionet Supreme të Auditimit, të zhvilluar nga Iniciativa për Zhvillim e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (e njohur si "IDI"), ka bërë vlerësimin e nevojave dhe domosdoshmërinë e hartimit të strategjisë së re. Po ashtu ka vlerësuar edhe zbatimin strategjisë 2018-2021 duke analizuar arritjet dhe ngeçjet në realizimin e objektivave strategjike që do shërbejnë si mësim për hartimin e strategjisë së re 3 vjeçare.

Për të hartuar strategjinë janë shfrytëzuar edhe dokumentet që janë përgatitur në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, anketimet e SIGMA-së me palët e interesit dhe personelin e ZKA-së, raporti i vlerësimit të strategjisë 2018-2021, si dhe raporti i vetëvlerësimit performances së Zyrës Kombëtare të Auditimit (SAI/PMF).

Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar se është e rëndësishme që ZKA-ja t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës sipas Kornizës së INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), dhe, në tetor 2021, ka marrë vendimin për të kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit sipas kësaj kornize.

Orientimet dhe synimet strategjike të ZKA-së janë bazuar në vizionin e Auditorës së Përgjithshme për përmirësimin e funksionimit të ZKA-së, rezultateve të diskutimeve nga takimet me menaxhmentin dhe stafin e ZKA-së.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar në disa faza kryesore:

Faza 1: Hartimi i Planit të punës- i cili ka mundësuar ZKA-së që të bëhet gati për procesin e planifikimit strategjik duke strukturuar procesin në mënyrë që të mobilizohen burimet e nevojshme dhe qartëson pritjet dhe rolet e përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm.

Faza 2: Diagnozifikimi i gjendjes ekzistuese - dhe Vlerësimi i Nevojave (VN)- në këtë fazë kemi bërë vlerësimin e nevojave, përkatësisht kemi definuar gjendja momentale e ZKA-së dhe krahasohet me gjendjen e dëshirueshme (p.sh. praktikatat më të mira ndërkombëtare/rajonale, vizioni për të ardhmen, etj) duke përcaktuar boshllëku në mes të dy gjendjeve.

Faza 3: Artikulimi i Vizionit, Misionit dhe Vlerave- pse ekziston ZKA-ja dhe aspiratat e saj për të ardhmen.

Faza 4: Identifikimi i çështjeve strategjike- në është kryer grupimi i boshllëqeve nga domenet e caktuara për të arritur tek çështjet strategjike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në arritjen e misionit të organizatës.

Faza 5: Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave- qëllimet dhe objektivat janë elementet kryesor i planit strategjik. Qëllimet janë të ndërlidhura me vizionin dhe misionin dhe përshkruajnë fushat e ndryshimit drejtues që ndikojnë në vlerën që krijon ZKA për palët e interesit.

Faza 6: Zhvillimi i treguesve të performancës- treguesit e performancës janë standardet që përdoren për të vlerësuar dhe komunikuar performancën kundrejt rezultateve të pritura.

Faza 7: Dokumentimi i Planit Strategjik- elementet e planit strategjik të punuara në fazat e mëparshme, vizioni, misioni, vlerat, qëllimet, objektivat, indikatorët e performancës bashkohen në një mënyrë kohezive në një dokument.

Sigurisht për të finalizuar komplet strategjinë përfshin edhe fazat e zbatimit të strategjisë që nënkupton:

Faza 8: Hartimi i Planit Operacional- Plani strategjik duhet të konvertohet në plane operative vjetore, bashkë me buxhetin vjetor. Plani vjetor përfshinë projektet, aktivitetet, afatet kohore, burimet që kërkohen, buxhetin e planifikuar, output-et, përgjegjësit për projektet, rreziqet eventuale, etj.

Faza 9: Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit- monitorimi i zbatimit të planit strategjik është procesi i përcjelljes së vazhdueshme të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme që ndodhin si pjesë e procesit të zbatimit.

Faza 10: Raportimi për Performancën- Për të demonstruar transparencën dhe llogaridhënien, ZKA duhet të komunikoj rezultatet e vlerësimit tek palët e brendshme dhe të jashtme. ZKA publikon raporte vjetore të performancës të cilat shpërndahen gjerësisht tek palët e interesit.



Adresa:

Zyra Kombëtare e Auditimit

Lagjja Arbëria

Rr. Ahmet Krasniqi, 210

10000 Prishtina

Republika e Kosovës